

Mos lejo më të tjetër të vendosin për ty

Elona Bano

Në një nga këto ditët plot lajme politike dhe elektorale mu rikujtua, a mbase e dëgjova të perifrashuar nga ndonjë prej analistëve tanë, një shprehje të Stalinit që fatkeqësisht tek ne është vërtetuar çuditërisht jo gjatë komunizmit, por në kulmin e demokracisë: “*nuk ka rëndësi se kush voton, rëndësi ka se kush numëron votat*”. Për të mu përforsuar edhe më shumë kjo frazë papritmas mu kujtua se në të vërtetë demokracia moderne nuk është më klasikja “pushtet i shumicës/popullit” por ka filluar të kufizohet në procesin e numërimit të votave.

Problematika e shoqërisë shqiptare në lidhje me votimet është tepër komplekse. Nga një anë ke skeptikët, të cilët çdo herë do të gjejnë diçka për të mos qenë dakord: ose infrastrukturën, ose observatorët ose numërimin ose...ose-t e tyre janë të pafund. Nga ana tjetër ke militantët të cilët jo vetëm që votojnë vetë por “i mbajnë pishën” edhe të afërmeve, komshinjeve në do shkojnë të votojnë dhe a do votojnë ashtu *siç duhet*. Kurse intelektualët janë kategoria më interesante, në pjesën më të madhe edhe pse e njohin më së miri institucionin e votës dhe rëndësinë e tij, e bojkotojnë atë. E këtu takohemi me paradoksin ku të gjallët e bojkotojnë votën ndërsa ka raste kur të vdekurit e ushtrojnë rregullisht këtë të drejtë.

Duhet të ndërjegjësohemi më në fund pas 50 vitesh ku vota jonë ishte inekzistente, pas 22 vjetësh ku vota jonë s’reshti së qeni e kontestuar na vetë ne, se nëse ne edhe njëherë në 4 vjet që mund të ushtrojmë këtë të drejtë, e bojkotojmë votën, atëherë i kemi vendosur demokracisë një kyç dhe kemi lejuar instalimin e tiranisë të një ASKUSHI mbi një popull të pandërgjegjshëm, të cilit nuk i intereson më fati i tij. Ka ardhur momenti që të peshojmë mirë se sa vlen secili prej tyre dhe sa vlen aktualisht vota jonë. Pasi është normale që udhëheqësit “e këqij” të zgjidhen pikërisht nga ata qytetarë të cilët bojkotojnë votimet.

Duhet që e gjithë shoqëria dhe sidomos rinia të kuptojë që vota është instrumenti më i rëndësishëm i shpikur ndonjëherë nga njerëzimi për ti dhënë fund padrejtësisë dhe për të rrëzuar muret e mospërfaqësimit dhe të pamundësisë së përgjithshme që e bën një pjesë të shoqërisë të ndihet ndonjëherë e pamundur.

Besoj se pas 22 vitesh demokraci dhe pluralizëm politik shoqëria shqiptare duhet të ketë kuptuar që kohët e militantizmeve të verbër tashmë kanë perënduar dhe tanimë duhet votuar jo për “Kë” po për “Çfarë”. Të votohet për një parim dhe vetëm nëse votohet kështu do të mund të kemi ndërgjegjen e pastër dhe të mendojmë të qetë që vota jonë nuk humb kurrë dhe nuk është vetëm një sasi a një numër por ajo do të sjellë cilësinë.

Gjithsesi është shqetësues fakti që shoqëria shqiptare edhe pse politikën e ka bukën e përditshme që e konsumon në çdo kafe, çdo tavolinë apo në çdo takim mes miqsh, dhe logjikisht duhet të merrte pjesë në mbi 80 % në votime, pjesëmarrja në votime është e ulët. Pse shqiptarët nuk para shkojnë në votime? A thua të jenë kaq indiferentë ndaj fatit të tyre? Apo të jemi të rënë pre e pesimizmit sipas të cilit nuk kemi shumë zgjidhje apo edhe më keq, zgjidhjet tona të mos kenë rëndësi? Po a është vallë e vërtetë që nëse nuk marrim pjesë në votime rëndësia jonë të rritet?! Çuditshëm apo jo kjo e fundit nuk është e vërtetë, procesi i votimeve do bëhet me apo pa secilin prej nesh, veçse ne duhet të bëjmë që mendimi dhe zëri ynë të dëgjohej duke ushtruar këtë të drejtë legjitime dhe kushtetuese. Në fakt edhe nëse e marrim nga pikëvështrimi etimologjik fjala “votime” vjen nga latinishtja “voce” pra “zë” ndërsa në gjuhët sllave “gollosovanie” nënkupton procesin e ngritjes së zërit.

Në hipotezën kur dikush nuk shkon të votojë për shkak se nuk ka një opsion të vlefshëm, nuk përfaqësohet nga platformat politike të asnjë prej partive, kjo është normale por nuk justifikon bojkotin. Qytetarit i mbetet akoma mundësia e kthimit në të pavlefshme të votës së tij, ose mundësia e votimit të bardhë. Nëse çdo qytetar bojkoton procesin zgjedhor, atëherë kjo nënkupton refuzimin total të këtij instrumenti që qëndron në themelin e organizimit të një shteti demokratik, ligjor dhe çka është më e rëndësishme në mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës. Nëse do të duam të kalojmë me këtë arsytim deri në ekstrem, atëherë në rast se pjesëmarrja në votime do të ishte zero, e vetmja rrugëdalje do të ishte Diktatura. A nuk na janë mjaftueshëm 45 vite diktaturë?!

Interesant është fakti që pothuajse në të gjithë ish kampin komunist, pjesëmarrja më e madhe nëpër votime ka qënë në zgjedhjet e para demokratike duke rënë kështu deri në ditët tona. Për shembull në zgjedhjet demokratike të 1990 në Estoni morën pjesë 78% e popullsisë, ndërkohë në 2003 vetëm 58%; në Lituani në 1993 morën pjesë 80 % ndërsa në 2004 vetëm 51%; në republikën Çeke në 1992 morën pjesë 85% e popullsisë ndërsa në 2006 vetëm 65%. Ndërsa në Shqipëri deri më 31 mars 1991 morën pjesë 99% e popullsisë kurse në korrik 1992 morën pjesë 71% e votuesve ose saktësisht 1.405.066 votues, kjo shifër duke u reduktuar në 2009 deri në 43% të popullsisë. Pra demokracia që duhet të jetë fuqia e shumicës, kthehet në fuqinë e pakicës aktive për shkak të mosushtimit të drejtës që ne na përket. Pasi demokracia nuk njeht një etalon tjetër në funksionimin e saj përveçse zgjedhjeve dhe votimit – pjesëmarrjes me zërin tënd.

Si konkluzion në këtë moment do të duhet të punojmë më shumë me të rinjtë votues, ti ndërjegjësojmë ata që Vota Rinore 2013 do të sjellë më shumë vlerë procesit të votimit dhe rezultati përfundimtar do të përfaqësojë një numër më të madh interesash dhe realitetesh. Ndaj do të duhet që të mos lejojmë të tjerët të vendosin më për ne.